# DËSHMI ARKIVI

**A-472638**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Gra serioze me funde të gjata” - deklarata e Tajanit ndez polemika në Itali! Senatorët dalin me funde në Parlament |
| ADRESA | `https://tpz.al/gra-serioze-me-funde-te-gjata-deklarata-e-tajanit-ndez-polemika-ne-itali-senatoret-dalin-me-funde-ne-parlament-i333971` |
| BURIMI | tpz.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 26 shtator 2026, 20:04:20 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 26 shtator 2026, 19:58:52 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `b9e7647d6eb2eb826e14fd43579cf2ddafc1a3e455f9c9b9d239150e043dddf4` |
| TEKSTI | `339afd2288a63c5e77cb89d0e7aebd831fa6f4829a9b3c208e78586578c83d60` |
| PAMJA | `021deb99e898143dbe30a0947aba03865bbf93d3dcf37a05cf00f5b12b6ec627` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `d690a2e80e64b5d2f5f0407b296e4819ec1440563fe11e5aa3ec8080e52006b8` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `20cb9bc098b6b22129b01f41a10ad3ad7e12cceb89fa0b5f21647847572e06c6` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/d690a2e80e64b5d2f5f0407b296e4819ec1440563fe11e5aa3ec8080e52006b8`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET, 26 SEPTEMBER 2026, 21:58

# "Gra serioze me funde të gjata" - deklarata e Tajanit ndez polemika në Itali! Senatorët dalin me funde në Parlament

TPZ



Ministri i Jashtëm italian, Antonio Tajani, është përfshirë në një debat të gjerë pas deklaratave të tij për mënyrën se si, sipas tij, duhet zgjedhur një partnere për martesë.

Komentet e tij shkaktuan reagime të forta nga opozita, sindikatat dhe organizata të tjera, ndërsa në rrjetet sociale Tajani u kthye në objekt memesh dhe imazhesh satirike.

Gjatë një aktiviteti javën e kaluar, Tajani tha se do të këshillonte të martoheshin me gra "serioze" që veshin "funde më të gjatë". Ai i përshkroi ato si më të besueshme dhe më të përshtatshme për të krijuar dhe mbajtur një familje.

Pas kritikave, Tajani kërkoi falje, duke thënë se fjalët e tij ishin shkëputur nga konteksti i një fjalimi më të gjerë dhe se nuk kishte pasur qëllim të ofendonte gratë.

Megjithatë, kërkimfalja nuk e ndali polemikën.

**Senatorët dalin me funde në shenjë proteste**

Senatore nga Partia Demokratike, Italia Viva, të Gjelbrit dhe Aleanca e së Majtës, Lëvizja Pesë Yjet dhe grupe të tjera u shfaqën në Parlament me funde, në shenjë proteste ndaj deklaratave të ministrit.

"Jemi të lira të vishemi si të duam", tha Raffaella Paita e Italia Viva, duke shtuar se liria e grave nuk duhet të matet me gjatësinë e një fundi apo me zgjedhjet e tyre personale.

Edhe Simona Malpezzi e Partisë Demokratike i kritikoi deklaratat, duke i cilësuar si shprehje të një kulture patriarkale.

## ide!

Ish-shefja e SHISH, nuk shantazhoi median, por kërcënoi armiqtë e saj
Nga Lorenc Vangjeli

Rikthimi i SHISH-it në politikë si banalitet
Nga Mero Baze

## Tej e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

## Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose kliko këtu për mënyra të tjera kontakti.

Messenger

## Moti

Tirana, Albania

## WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super

imuniteti Gent Sejkos

Shiko të tjera video

Polemika u zgjerua edhe pas komenteve të Roberto Vannaccit, i cili tha se mes një gruaje me fund të gjatë dhe një gruaje me fund të shkurtër, ai do të preferonte "një grua pa fund".

Ndërkohë, shumë deputetë të opozitës publikuan fotografi me funde në rrjetet sociale.

Një prej tyre, Andrea Ciulli, publikoi edhe një imazh të krijuar me AI, të shoqëruar me mesazhin se gjatësia e një fundi nuk përcakton vlerën apo lirinë e një gruaje.

**Tajani kthehet në objekt memesh**

Kreu i Italia Viva, Matteo Renzi, tha se Tajani tashmë është kthyer në "meme", ndërsa imazhe satirike të ministrit të veshur si grua u përhapën në rrjetet sociale dhe u pasqyruan edhe nga media ndërkombëtare.

Sindikatat italiane kritikuan gjithashtu deklaratat, duke argumentuar se ndarja e grave në "serioze", "të besueshme" dhe "tërheqëse", bazuar edhe në mënyrën e veshjes, rikthen stereotipe të vjetra për rolin e grave në shoqëri.

Edhe Konferenca Ipeshkvnore Italiane (CEI) bëri thirrje për respekt dhe dinjitet në mënyrën se si flitet për gratë.

**Meloni dhe qeveria e mbrojnë Tajanin**

Kryeministrja italiane Giorgia Meloni e minimizoi polemikën, duke i cilësuar fjalët e Tajanit si një "shprehje të ngathët" dhe duke bërë thirrje që çështja të mos ekzagjerohej.

Edhe ministri i Mbrojtjes, Guido Crosetto, e mbrojti Tajanin, duke argumentuar se ai kishte folur për llojin e partneres që do t'i këshillonte djalit të tij, bazuar në vlerat e veta, dhe jo për mënyrën se si duhet të vishen gratë.

Polemika vijon të jetë pjesë e debatit publik në Itali, ndërsa Tajani mbetet në qendër të kritikave dhe reagimeve në rrjetet sociale.



AKTUALITET / 26 September 2026, 21:45

Rama kthehet nga SHBA, nesër mesazh për shqiptarët

AKTUALITET / 26 September 2026, 21:24

Tragjedia me 6 viktima në Athinë, reagon Ministria e

nga aeroporti "Nënë Tereza"

Jashtme e Shqipërisë: Jemi thellësisht të pikëlluar

AKTUALITET / 26 September 2026, 21:15

## Ndahet nga jeta Luca Turi, fotografi që fiksoi në objektivin e tij eksodin e 20 mijë shqiptarëve

AKTUALITET / 26 September 2026, 21:07

## Gogu në Kongresin e OKB-së: Instituti i Edukimit dhe Rehabilitimit të të Miturve do të jetë funksional në 2027

AKTUALITET / 26 September 2026, 20:55

## "U ndjeva si në Tiranë"/ Rama nga SHBA: Më hodhën vezë, njëri kishte ardhur nga Britania, edhe shefi i policisë ishte shqiptar

AKTUALITET / 26 September 2026, 20:45

## Tre shqiptarë mes 6 viktimave në tragjedinë e Athinës, ende mister shkaku i shpërthimit! Zbardhen pistat që po hetojnë autoritetet

AKTUALITET / 26 September 2026, 20:37

## Rama takim me komunitetin shqiptar në New York: Shqipëria e sotme nuk është më vendi që ka nevojë për ndihma! Kemi nisur krijimin e regjistrit Kombëtar të Diasporës

AKTUALITET / 26 September 2026, 20:31

## Mbyllen hetimet për vrasjen e gjyqtarit Astrit Kalaja, Prokuroria i komunikon akuzën Elvis Shkambit

AKTUALITET / 26 September 2026, 19:55

## Ndryshimet e Maran, zbulohet formacioni i Shqipërisë ndaj Bjellorusisë

AKTUALITET / 26 September 2026, 19:43

## “Na ndërpreu takimin, shau dhe mallkoi”, Braçe reagon pas përplasjes me aktivisten

AKTUALITET / 26 September 2026, 19:26

## Ndeshja Shqipëri-Bjellorusi, zbulohet sa bileta janë shitur

AKTUALITET / 26 September 2026, 18:51

## "Duhet respektuar sovraniteti"/ Kina kundërshton SHBA-në për Iranin dhe Kubën në OKB

AKTUALITET / 26 September 2026, 18:26

## Ambasadori Nesho komenton ambasadorin Wendt: Yuri Kim na prodhoi konflikt, por Wendt ka integritet dhe nuk përulet!

AKTUALITET / 26 September 2026, 18:12

## Ishte dënuar për vrasjen e gruas, 49-vjeçari dyshohet se është vetëvrarë në burgun e Reçit

AKTUALITET / 26 September 2026, 18:05

## “Po i çmontojnë një nga një”, Artan Hoxha ngre alarmin për kriminalitetin në Sarandë

AKTUALITET / 26 September 2026, 17:43

## Senatorët republikanë dhe demokratë thirrje Trump: Mos e fto Putinin në samitin e G20

AKTUALITET / 26 September 2026, 17:12

## “As Netflix nuk do ta

AKTUALITET / 26 September 2026, 16:53

## Po transportonin emigrantë të

imagjinonte. Skenar apokaliptik"/ Artan Hoxha për skandalin e Vlora Hysenit: Këtë që ndodhi me SHISH-in nuk do ta arrinte as një shërbim armik

paligjshëm, dy "Audi" tentojnë të ikin por përplasen me patrullën e Policisë! Shpallen në kërkim dy drejtuesit

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.